



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika e e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 8, paragrafi 1 i Ligjit nr. 04/L – 144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 2 të Rregullores së QRK - së nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe të këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 06.08.2018, miratoi këtë

V E N D I M
P Ë R
FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1

Miratohet Vendimi për formimin e Komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.

Neni 2

Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në përbërje nga shtatë (7) anëtarë:

1. Muhedin Nushi, përfaqësues nga ekzekutivi,
2. Genc Bashota, përfaqësues nga ekzekutivi,
3. Ardian Olluri, përfaqësues nga ekzekutivi,
4. Bashkim Beha, përfaqësues nga Kuvendi,
5. Migjen Shala, përfaqësues nga Kuvendi,
6. Shefki Gashi, përfaqësues nga Kuvendi,
7. Allen Meta, përfaqësues nga shoqëria civile.

Neni 3

Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues është: caktimi i kryesuesit të Komisionit, përpilimi i njoftimit publik me të dhënat për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, prezenca në ankand publik/hapjen publike të ofertave, vlerësimi final i ofertave më të favorshme ekonomikisht, në pajtim me kriteret e përcaktuara me njoftimin për ankand publik dhe shprehje të interesit, dërgimi në Kuvendin e Komunës për miratim të ofertës së përzgjedhur për dhënien afatgjate dhe çështje të tjera, të cilat konsiderohen të rëndësishme nga Komisioni vlerësues i ofertave.

Neni 4

Mandati i anëtarëve të komisionit nuk mund të zgjatë më shumë se mandati ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 5

Organet e administratës dhe njësitë e tjera të Komunës, do t'i ofrojnë përkrahje Komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë dha afatshkurtër.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe publikimi në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01-020/04-194122/18, më 08.08.2018

KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta



A r s y e t i m

Për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L – 144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe të Rregullores QRK nr. 23/2013, për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, formohet Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim, i cili përbëhet nga shtatë (7) anëtarë.

Kryetari i Komunës i propozon tre (3) anëtarë të këtij komisioni nga ekzekutivi i Komunës, Kuvendi i Komunës i propozon tre (3) anëtarë nga subjektet e përfaqësuara në Kuvendin e Komunës dhe një (1) anëtar, ekspert nga shoqëria civile.

Për të zbatuar të cekurën më lart, është propozuar që ky komision, si në pikën II të këtij vendimi, të miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit.

Vendimi përmban detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues, si dhe përkrahjen që këtij komisioni do t'ia japin njësitë përkatëse të administratës së Komunës gjatë zhvillimit të procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme.